

VENDIM
Nr.285, datë 10.4.2020

**PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN SI DHE PROCEDURAT E NIVELI I
TARIFAVE TË SHËRBIMEVE QË DO TË OFROHEN NGA AGJENCIA E
TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE (ATRAKO)**

(ndryshuar me vendimin nr. 612, datë 22.9.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi janë organizimi dhe funksionimi i Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (në vijim ATRAKO), në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e koncesioneve/partneritetit publik privat dhe me këtë vendim, si dhe procedura për përcaktimin e tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO).

2. ATRAKO është institucion publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë. Buxheti i Agjencisë financohet nga buxheti i shtetit, gjithashtu, dhe nga donatorë të ndryshëm dhe miratohet me buxhetin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, si zë i veçantë.

3. Misioni i ATRAKO-s është të nxisë dhe të asistojë autoritetet kontraktuese në përgatitjen, vlerësimin dhe negociimin e koncesioneve/partneriteteve publike private.

4. ATRAKO ka fushë përgjegjësie ndihmën dhe këshillimin e autoriteteve kontraktuese si dhe sigurimin e standardeve për zbatimin e procedurës së koncesionit, nëpërmjet unifikimit dhe hartimit të modeleve standarde.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË ATRAKO-S

ATRAKO ka përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

a) Të organizojë punën për të nxitur dhe këshilluar autoritetet kontraktuese në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private;

b) Të organizojë punën për hartimin dhe unifikimin e modeleve standarde;

c) Të organizojë punën për monitorimin dhe analizimin e tendencave aktuale evropiane dhe globale në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, me qëllim propozimin e ndryshimeve ligjore dhe promovimin e praktikave më të mira ndërkombëtare.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ATRAKO-S

1. ATRAKO e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. Struktura dhe organika e ATRAKO-s miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

3. ATRAKO kryen detyrat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi në fushën e koncesioneve/partneritetit publik privat, si dhe në çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që lidhet me këtë fushë.

4. ATRAKO bashkëpunon me ministritë e linjës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim mbledhjen e të dhënave mbi procedurat për dhënien me koncesion dhe partneritet publik privat.

Ministritë e linjës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të dorëzojnë pranë Agjencisë të gjitha kontratat e koncesionit/PPP, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas nënshkrimit të tyre.

5. ATRAKO bashkëpunon me Agjencinë e Prokurimeve Publike, për të publikuar dokumentet standarde të procedurës konkurruese të koncesionit dhe partneritetit publik privat.

6. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, me propozim të kryetarit të Agjencisë.

7. ATRAKO drejtohet nga kryetari, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e saj dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët. Kryetari i ATRAKO-s përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ka detyrat, si më poshtë vijon:

- a) Cakton objektivat dhe detyrat e njësive organizative në përbërje të ATRAKO-s;
- b) Bashkërendon punën midis njësive organizative në përbërje të ATRAKO-s;
- c) Nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshme, me qëllim marrjen e masave dhe përmbushjen me efikasitet të detyrave e të objektivave të ATRAKO-s si dhe disiplinimin e aktiviteteve të saj.

8. *Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të ATRAKO-s rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.*

8/1. *Kryetari i ATRAKO-s emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë. Kryetari i ATRAKO-s duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:*

- a) *të jetë shtetas shqiptar;*
- b) *të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- c) *të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 (njëqind e njëzet) kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vjet akademikë” ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë për shkencat ekonomike/juridike;*
- ç) *të ketë përvojë në profesion, të paktën 3 (tre) vjet;*
- d) *të shquhet për figurë të pastër etiko-morale;*
- dh) *të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;*
- e) *ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;*
- ë) *të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;*
- f) *të mos ketë konflikt interesi me detyrën, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.*

8/2. *Kryetari i ATRAKO-s lirohet nga detyra, kur:*

- a) *plotëson moshën për pensionin e plotë të plegërisë;*
- b) *deklarohet i paafitë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;*
- c) *gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;*
- ç) *jep dorëheqjen nga detyra.*

8/3. *Kryetari i ATRAKO-s shkarkohet nga detyra, kur:*

- a) *dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo të një kundërvajtjeje penale me dashje;*
- b) *konstatohen shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë legjislacionin specifik mbi të cilën ushtron veprimtarinë e ATRAKO-s;*
- c) *kryen veprimtari që krijon konflikt interesash;*
- ç) *konstatohet në kushtet e ndalimit për kryerjen e funksioneve publike, sipas legjislacionit për integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike;*
- d) *kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;*
- dh) *vërtetohet se ka përgjegjësi për mosrealizimin e objektivave të vendosur për ATRAKO-n.*

9. ATRAKO ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema e ATRAKO-s përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e (emri i ministrisë përgjegjëse), Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

10. Vula e ATRAKO-s ka formën dhe elementet e paracaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. PROCEDURA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA ATRAKO

1. ATRAKO siguron të ardhura nga shërbimet që kryen në dobi të autoriteteve kontraktuese dhe nga donatorë të ndryshëm.

2. Tarifa për shërbimet e ofruara nga ATRAKO shpallet në dokumentet e procedurës konkurruese dhe paguhet nga operatori fitues, përpara nënshkrimit të kontratës, me autoritetin kontraktues, si më poshtë vijon:

a) Për projekte koncesioni/PPP me vlerë investimi deri në 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë, tarifa është 700 000 (shtatëqind mijë) lekë;

b) Për projekte koncesioni/PPP me vlerë investimi mbi 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë deri në 2 100 000 000 (dy miliardë e njëqind milionë) lekë, tarifa është 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë;

c) Për projekte koncesioni/PPP me vlerë investimi mbi 2 100 000 000 (dy miliard e njëqind milionë) lekë deri në 7 000 000 000 (shtatë miliardë) lekë, tarifa është 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë;

ç) Për projekte koncesioni/PPP me vlerë investimi mbi 7 000 000 000 (shtatë miliardë) lekë, tarifa është 4 200 000 (katër milionë e dyqind mijë) lekë.

3. Të ardhurat e përfituara sipas pikës 2, të këtij kreu, do të derdhen në buxhetin e shtetit.

4. Administrimi dhe veprimtaria financiare auditohet nga ministria përgjegjëse për ekonominë dhe institucionet e tjera të ngarkuara me ligj për auditim.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Vendimi nr.150, datë 22.3.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. ATRAKO mbart të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, të krijuar me vendimin nr.150, datë 22.3.2007, të Këshillit të Ministrave.

3. Nëpunësit civilë të ATRAKO-s do të trajtohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil, në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucionit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe ATRAKO për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama